URDHËR
Nr. 922, datë 28.10.2024

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË DHE DELEGIMIT TË KOMPETENCAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë"; si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 81/2022, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme",

URDHËROJ:

1. Znj. Silda Çepe, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) ndjekjen e zbatimit të politikave për diasporën dhe koordinimin me institucionet e tjera përgjegjëse për këto politika;

b) koordinimin teknik, monitorimin dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të angazhimeve të marra për çështjet e diasporës.

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara, që ndërlidhen në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 46, datë 31.1.2024, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani